# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446799**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/trafiku-i-s-korrupsioni-dhe-projekti-i-kushner-seance-degjimore--i514298` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 17:10:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 16:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2b069d0a8c7f899201195ff7b12886611aef51dace3cf46be64bda1aab02b5db` |
| TEKSTI | `b3c17f377bdc57a9a965288a8a31b50ebf69e83b9b53bc85325f00e98d84122b` |
| PAMJA | `d3e9fdc148f0cad37b3b4969cd3c4a1348f42589ee021e7dead5a906bd371618` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b20f89116318ae10652fe3f47a3adeb65734ea944e8de6e910bdcc94831e11b1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcdc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b20f89116318ae10652fe3f47a3adeb65734ea944e8de6e910bdcc94831e11b1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA

Wilson e pyeti administratën amerikane se cilat janë hapat që po ndërmerren për të luftuar trafikun e narkotikëve dhe rrjetet kriminale që veprojnë në Shqipëri. Në përgjigje, Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, deklaroi se Shtetet e Bashkuara vijojnë bashkëpunimin me autoritetet shqiptare për goditjen e organizatave kriminale transnacionale.

dosja

15 Shtator 2026, 18:15
Nga E. D




Joe Wilson, Daniel Lawton

**SHBA-** Shqipëria ishte në fokus të një seance në Kongresin amerikan, ku u diskutuan lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikut të narkotikëve, integriteti i zgjedhjeve, korrupsioni dhe zhvillimet politike në Ballkanin Perëndimor. Çështja e Shqipërisë u ngrit nga kongresmeni republikan Joe Wilson, i cili shprehu shqetësim për ndikimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe problematikave të integritetit zgjedhor.

Wilson e pyeti administratën amerikane se cilat janë hapat që po ndërmerren për të luftuar trafikun e narkotikëve dhe rrjetet kriminale që veprojnë në Shqipëri. Në përgjigje, Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, deklaroi se Shtetet e Bashkuara vijojnë bashkëpunimin me autoritetet shqiptare për goditjen e organizatave kriminale transnacionale.

Sipas tij, këto organizata kanë shtrirje dhe lidhje ndërkombëtare, përfshirë lidhje me kartele kriminale në Hemisferën Perëndimore. Një pjesë e rëndësishme e përgjigjes së zyrtarit amerikan iu kushtua SPAK.

Lawton tha se Shtetet e Bashkuara e kanë konstatuar strukturën e posaçme si "relativisht efektive" në trajtimin e disa prej çështjeve të ngritura gjatë seancës. Lawton e vendosi gjithashtu zhvillimin e Shqipërisë në një kontekst historik, duke vlerësuar ndryshimin e vendit pas rënies së komunizmit.

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44
Skema se si IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 13:00
"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni kaq të madhe, është laps

*"Shtetet e Bashkuara po vijojnë që të punojnë me qeverinë shqiptare për të luftuar organizatat kriminale transnacionale që veprojnë atje. Kemi konstatuar se struktura e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar SPAK ka qenë relativisht efektive në trajtimin e disa prej çështjeve që ju ngritët. Për mua është frymëzuese të shohim që shteti më komunist gjatë Luftës së Ftohtë tani është i lirë, ndaj ne duam që Shqipëria të ketë sukses"*, u shpreh Lawton.

**Kongresmeni republikan Joe Wilson:** Ne mund të luajmë një rol në monitorimin dhe promovimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Për më tepër, është raportuar se korrupsioni, krimi i organizuar dhe integriteti zgjedhor në Shqipëri po ndikohen nga qeveria e Edi Ramës, e cila, në fakt, po nxit krijimin e një rrjeti të trafikut të narkotikëve. Ndër vite, Shtetet e Bashkuara kanë qenë vërtet të suksesshme në bashkëpunimin me autoritetet kundër krimit dhe trafikut të organizuar të drogës për ta trajtuar këtë çështje. Çfarë po bën administrata në përgjigje të trafikut të narkotikëve në Shqipëri?

**Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton:** Kongresmen Wilson, ju falënderoj gjithashtu për këtë pyetje të rëndësishme. Mund t'ju siguroj se Shtetet e Bashkuara po vijojnë që të punojnë me qeverinë shqiptare për të luftuar organizatat kriminale transnacionale që veprojnë atje. Këto organizata kanë lidhje ndërkombëtare me kartelet këtu në Hemisferën Perëndimore. Në veçanti, kemi konstatuar se struktura e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar SPAK ka qenë relativisht efektive në trajtimin e disa prej çështjeve që ju ngritët. Për mua është frymëzuese të shohim që shteti më komunist gjatë Luftës së Ftohtë tani është i lirë, ndaj ne duam që Shqipëria të ketë sukses.

Diskutimi në Kongres zhvillohet në një kohë kur lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, forcimi i institucioneve të drejtësisë dhe integriteti i zgjedhjeve mbeten çështje të rëndësishme për Shqipërinë, edhe në kuadër të procesit të Integrimit Europian.**/Dosja.al**

joe wilson | bill keating


ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

## më të klikuarat

Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Dhunuan me grusht qytetarin gjatë arrestimit, Taulant Balla i del në mbrojtje Policisë: Bën detyrën e tyre

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

## Sondazh

Poll

## insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Moti

Powered by tomorrow

Aktualitet

15 Shtator 2026, 18:07

# REL: Sa pushtet kishin? Thaçi dhe të tjerët para verdiktit

Vendimi në shkallë të parë për ish-krerët e UÇK-së shpallet më 16 shtator, 2026. Më 16 shtator, Hashim ...

'Dritë jeshile' për ekstradimin e Ervin Matës, Gjykata Supreme në Brazil shqyrton kërkesën e Shqipërisë

Aktualitet

15 Shtator 2026, 17:58

### Apeli e shpalli të pafajshëm për atentatin e dështuar ndaj Gazmir Dacit, GJL kthen për rigjykim çështjen e Ergys Kolaverit

Aktualitet

15 Shtator 2026, 17:33

### Aksident i rëndë në superstradën Lezhë-Shkodër/ Plagosen tre persona, dërgohen në urgjencë

Aktualitet

15 Shtator 2026, 17:26

### Vendimi për Hashim Thaçin/ Ambasadori kroat Zlatko Kramariç: Nuk është mirë që Thaçi të dënohet, shpresoj që procesi të mos jetë politik por i drejtë

Aktualitet

15 Shtator 2026, 17:11

Aktualitet

15 Shtator 2026, 16:52

## Aksident i rëndë në aksin Maqellarë-Peshkopi/ Raportohen 5 të lënduar, 4 prej tyre nisen drejt Traumës

Foto ilustruese DIBËR- Një aksident i rëndë rrugor është regjistruar ditën e sotme në aksin nacional Maqellarë...

### REL: Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

Aktualitet

15 Shtator 2026, 16:28

Rishfaqet "diMAL", pas mishit te infektuar, drogë në kontejner

Aktualitet

15 Shtator 2026, 16:00

---

I njohur për arratisjet spektakolare dhe vrasjet e shumta/ Si arriti Alket Rizai të merrte 16 leje për të dalë nga qelia e burgut grek?

Aktualitet

15 Shtator 2026, 14:44

---

SKANDAL/ Deputetja Zegjine Çaushi ishte në dijeni se daja i saj kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe

Aktualitet

15 Shtator 2026, 13:54

MË SHUMË




Korreshi përplaset me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Nuk e ke kuptuar ende punën e një deputeti


Korreshi përplaset me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Nuk e ke kuptuar ende punën e një deputeti


"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste


"Paga bruto e një magjistari"/ Gafa e deputetes socialiste Aulona Bylykbashi


Daja i deputetes Zegjine Çaushi plagosi ish-vjehrrin me drapër, rrëfehet partnerja: Më ka dhunuar...

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]



MUNDESUAR NGA Mediadesk

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.